



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Komunikimi ndërkombëtar (2017/2018)**

Fakulteti	Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180 / 240
Kodi	N-COMMIC
Titulli	I diplomuar në komunikimin ndërkombëtar
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-2119/3
Numri në arkiv i akreditimit [240]	03-1619/15 (10.11.2017)
Vendimi për fillim me punë	03-1619/15 (10.11.2017)
Data akreditimit	30.08.2017

Përshkrimi i programit

Programi studimor Komunikimi ndërkombëtar, ngërthen studime interdisiplinare dinamike dhe interaktive. Nga këto studime pritet të gjenerohen rezultate profesionale të adaptuara për nevojat e tregut global integrativ, por njëkohësisht ato do të shërbejnë si bazë për studime të nivelit postdiplomik (cikli i dytë i studimeve).

Ky program i përgatit studentët për vende pune në institucione dhe organizata ndërkombëtare, në industrinë dhe mediat, për vende pune në teknologji dhe strategji komunikuese të cilat rriten dhe evoluojnë shpejt dhe përdoren nga korporata dhe organizata të tjera, si dhe për vende pune për marrëdhënie me publikun dhe trajnimin e zhvillimin e politikave kadrovike. Programi mësimor për Komunikim ndërkombëtar është dizajnuar që t'i plotësojë nevojat e tanishme dhe të ardhshme të tregut për punë në sfera të caktuara të komunikimit ndërkombëtar, në krijimin e politikave në nivel nacional dhe ndërkombëtar dhe për zhvillim korporativ në fushën e mediave, të komunikimit digjital dhe interaktiv, për zhvillim të portaleve, gazetarisë, për komunikim korporativ dhe të organizatës si dhe të marrëdhënieve me publikun, etj. Programi studimor për Komunikim ndërkombëtar u ofron studentëve kuptim të thellë dhe njohuri nga sfera e shkathtësive komunikuese ndërkombëtare dhe njëkohësisht i orienton në sfera të caktuara, të cilat do të specializohen në ciklin e dytë të studimeve. Përparësi plotësuese është ajo që studentët në semestrin e fundit marrin pjesë në praktika studentore, nëpërmjet të cilave kanë mundësi të përfitojnë përvojë në aspektin aplikativ të shkencave të komunikimit.

Universiteti i E.JL posedon infrastrukturë teknologjike të jashtëzakonshme për realizim të kurrikulumit të propozuar në drejtimin e shkencave të komunikimit me laboratore kompjuterike, rrjetë interneti dhe mundësi për të mësuar në distancë, si dhe bibliotekë me on-line resurse të kapshme për kërkim.

Vitin e fundit studentët punojnë në projekte të mëdha individuale ose ekipore të cilat janë në formë të punës hulumtuese, zhvillimore, konstruktive ose praktike dhe në bashkëpunim të afërt ose nëpërmjet praktikës në kompani të vendit ose globale, institucione dhe media shoqërore-politike nacionale dhe ndërkombëtare. Kjo përvojë kultivon njohuri të zhvilluara teknike, përdorim të mendimit analitik, rezonim kuantitativ, shkathtësi për menaxhim me projekte, si dhe shkathtësi komunikuese. Prezantimi i projektit final pritet në fund të këtij programi.

Karriera

Programi i Komunikimit ndërkombëtar është veçanërisht i përshtatshëm për ata të interesuar për punësim dhe karrierë

profesionale në:

- organizata ndërkombëtare,
- diplomaci
- korporata shumëkombëshe,
- media,
- zyra të marrëdhënieve me publikun,
- organizata joqeveritare ndërkombëtare, etj.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Përfitim i bazës teorike, njohuri dhe kuptueshmëri e shkencave të komunikimit në përgjithësi, dhe posedim i njohurive më të thella për teoritë dhe qasjet globale nga komunikimi ndërkombëtar.
- Përfitim i njohurive hyrëse për modelet ndërkombëtare komunikuese, llojet e fushatave komunikuese dhe strategji për marrëdhënie me publikun, karakteristikat themelore të diplomacisë dhe mënyra e funksionimit të organizatave ndërkombëtare.
- Zhvillim i të menduarit kritik për komunikim ndërkombëtar.
- Të shkruar kompetent dhe të folur kompetent në publik dhe atmosferë private.
- Përfitim i përvojës praktike për komunikim ndërkombëtar.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Të realizojnë hulumtime dhe të jenë analitikë në sferën e komunikimit ndërkombëtar.
- Aftësi për menaxhim me programe dhe obligime të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare si dhe të udhëheqë trajnime dhe konsultime për shkathtësi komunikuese të aspektit nacional dhe ndërkombëtarë.
- Aftësi për menaxhim me konflikte, sjellje të vendimeve dhe zhvillim të ekipeve.
- Aftësi për mbajtje të marrëdhënieve me publikun dhe zhvillim të marrëdhënieve për publikun, marketing të fushatave në nivel vendor, nacional dhe global.
- Aftësi për analizë të publikut në nivel vendor dhe ndërkombëtar, kuptueshmëri për raportin mes shoqërisë, mediave, mesazheve, institucioneve ndërkombëtare dhe publikut.

Aftësitë për të vlerësuar

- Ndhmon në evaluimin e problemeve konkrete në lidhje me komunikimin ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planifikim të komunikimeve, menaxhment të proceseve, kontrollit dhe menaxhment strategjik;
- Posedon aftësi që të analizojë konkurrencën mediale të tregut.
- Studentët do të jenë të aftë të kyçen në debate në media dhe t'i argumentojnë qëndrimet e tyre, të bazohen në fakte, për tema në lidhshmëri me objektivitetin në gazetari, krijim të mendimit publik, etikën e mediave, trende moderne të marketingut bashkëkohor dhe marrëdhënie me publikun.
- Do të mund të vlerësojnë cilat janë strategjitë dhe taktikat më të përshtatshme të cilat do të duhet të zbatohen në fushata konkrete për marrëdhënie me publikun në nivel vendor dhe global.

Aftësitë e komunikimit

- Bën prezantimin e ideve, koncepteve dhe strategjive të reja nga sfera e komunikimit ndërkombëtar.
- Njohuri të avancuara të gjuhëve të huaja për komunikimin ndërkombëtar të nivelit akademik.
- Të angazhohen në mënyrë efikase dhe konstruktive në sfera përkatëse profesionale nga komunikimi ndërkombëtar.
- Të japin prezantim të qartë dhe koherent për ndonjë temë ose detyrë duke përdorur shembuj dhe zgjedhje referente.
- Të përdorin burime të avancuara për përsosje dhe implementim të njohurive të përfituara.
- Të shprehin qartë dhe në mënyrë elokumente, si dhe të përfitojnë shkathtësi për të folur në publik.
- Studentët do të marrin pjesë në krijimin e rregullave dhe karakteristikave të debateve dhe në mënyrë aktive do të debatojnë në tema që janë në lidhshmëri me komunikimin ndërkombëtar.

Aftësitë e të mësuarit

- Mund të kërkojë dhe detektojë burime për të mësuar;
- Posedon aftësi të bëjë analiza nga sfera e komunikimit ndërkombëtar dhe të përdorë literaturë shkencore dhe shqyrtime nga autorë tjerë;
- Mund të mësojë në mënyrë individuale dhe në ekip;

- Avancim i mëtutjeshëm i njohurive nëpërmjet shkathtësive për mësim interaktiv, mësim me përpilim të projekteve komunikuese praktike, të menduar kritik dhe analizë të përmbajtjeve të mediave ndërkombëtare.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [CCM-102] [6.0 SETK] **Hyrje në komunikim ndërkombëtar dhe ndërkulturor**
- [CCM-101] [6.0 SETK] **Hyrje në shkencat e komunikimit**
- [CCM-103] [6.0 SETK] **Hyrje në marrëdhëniet ndërkombëtare**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 2

- [CCM-201] [6.0 SETK] **Studimet e mediave**
- [CCM-202] [6.0 SETK] **Teoritë e komunikimit**
- [CCM-203] [6.0 SETK] **Hyrje në shkencat politike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë shqipe/maqedonase**

Semestri 3

- [CCM-301] [6.0 SETK] **Metodat e hulumtimit në komunikim**
- [CCM-302] [6.0 SETK] **Diplomacia**
- [ECM-302] [6.0 SETK] **Komunikimi ndërkombëtar dhe identiteti kulturor**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze për qëllime specifike 1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 4

- [CCM-401] [6.0 SETK] **Sistemet ndërkombëtare të komunikimit**
- [CCM-402] [6.0 SETK] **Marrëdhënie me publikun: parimet dhe praktikat**
- [CCM-403] [6.0 SETK] **Organizatrat ndërkombëtare**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze për qëllime specifike 2**

Semestri 5

- [CCM-504] [6.0 SETK] **Praktika profesionale**
- [CCM-501] [6.0 SETK] **Të shkruarit dhe raportimi medial**
- [CCM-502] [6.0 SETK] **Komunikimi politik**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 6

- [CCM-602] [6.0 SETK] **Negociatat**
- [CCM-603] [6.0 SETK] **Komunikimi dhe lidhshipi**
- [LCC-601] [6.0 SETK] **Punim diplome**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 7

- [ECM-301] [6.0 SETK] **Mediat ndërkombëtare**

- [CCM-503] [6.0 SETK] **Globalizimi**
- [CCM-701] [6.0 SETK] **Korrespondencë diplomatike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 8

- [ECM-603] [6.0 SETK] **Politikat ndërkombëtare**
- [CCM-801] [6.0 SETK] **Rrjetat sociale**
- [CCM-802] [6.0 SETK] **Komunikimi ndërkombëtare dhe zgjidhja e konflikteve**
- [LCC-802] [6.0 SETK] **Projekt - Rast studimor**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Hyrje në komunikim ndërkombëtar dhe ndërkulturor**

Pas mbarimit të lëndës hyrje në shkencat e komunikimit prej studentëve do të pritet të mund të gjenden në bisedat e thjeshta, të mund të aplikojnë dituritë për skemat e Shenanit dhe Viverit, të mund t'i tejkalojnë themelet e modeleve gjuhësore të komunikimit. Po ashtu, prej studentëve do të pritet që në mënyrë të pavarur t'i përdorin këto njohuri për nevojat e tyre të mëturshme, po njëherësh edhe si bazë për zhvillim të komunikimit

- **Hyrje në shkencat e komunikimit**

Studentët do të mund të definojnë komunikimin ndërkulturor, do të mund t'i identifikojnë dhe t'i sqarojnë politikat ndërkulturore, e ndërsa njohurinë dhe të kuptuarit do t'i aplikojnë në përpunimin e strategjive ndërkulturore me aftësi për vlerësim të identifikatorëve të identitetit të kulturave të ndryshme që ekzistojnë në Republikën e Maqedonisë dhe në korniza botërore.

- **Hyrje në marrëdhëniet ndërkombëtare**

Studentët njoftohen me konceptet më të rëndësishme, idetë dhe institucionet e marrëdhënies ndërkombëtare. Lënda paraqet hulumtim të koncepteve themelore të disiplinës, me tendencë për t'i njoftuar studentët me skenën aktuale të marrëdhënies ndërkombëtare (MN) dhe me problemet bashkëkohore ndërkombëtare, si dhe me ardhmërinë e MN duke i diskutuar agjendat e reja. Në përfundim të lëndës studentët do të duhet të jenë në gjendje/ të përgatitur të: - zotërojnë një kuptim/ njohuri për konceptet dhe temat të disiplinës së MN; - mësojnë fuqitë udhëheqëse dhe ndodhitë, ndikimet dhe idetë që e ndërtojnë evolucionin e MN; artikulojnë dhe analizojnë temat e MN nga perspektiva të ndryshme.

- **Studimet e mediave**

Qëllimet e programit të lëndës (kompetencat) janë: - T'i përgatitë studentët në funksionet themelore të mediave dhe mjeteve për komunikim masiv, - T'i njoftojë me ndikimin e tyre dhe rëndësinë e shoqërisë, - T'i njoftojë me profesionin gazetaresk, - T'i njoftojë me funksionet dhe llojet e gazetarisë dhe prodhimeve gazetareske.

- **Teoritë e komunikimit**

Pas mbarimit të teorive të komunikimit, prej studentëve pritet të arrijnë njohuri të dhura dhe përparim në fushën e modeleve psikologjike të komunikimit. Përveç kësaj, prej studentëve pritet të bëhen më të pavarur gjatë studimit të modeleve të njëjta dhe të marrin përgjegjësi për nxënien e tyre. Pas mbarimit të teorisë së komunikimit, studentët do të jenë të trajnuar të përpunojnë dhe të krijojnë shembuj nga modelet e Frojdit, teorinë e anksozitetit dhe sjelljes dhe do të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike për tema të ndryshme dhe të sjellin vetë përfundime në bazë të teksteve të lexuara, si dhe të fitojnë aftësi për komunikim të avancuar me shkrim dhe me gojë në fushën e teorive të ndryshme psikologjike të komunikimit.

- **Hyrje në shkencat politike**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i përgatitë studentët me bazat e shkencave politike. Do të prezantohen konceptet kryesore politike, termet, idetë dhe institucionet. Lënda është dizajnuar si një hyrje në natyrën e studimit të politikës duke përfshirë shqyrtimin e koncepteve themelore të disiplinës: qeverinë, autoritetin, legjitimitetin. Sovraniteti, kombi, shteti, llojet e regjimeve. Në mënyrë të veçantë do të studiohen ideologjitë kryesore në teorinë politike.

- **Metodat e hulumtimit në komunikim**

Si një disiplinë shkencore e shkencave të komunikimit, lënda metodat komunikative të hulumtimit ka për qëllim t'u bëjë analizë të qasjeve më të zhvilluara teorike- metodologjike në hulumtimet bashkëkohore komunikuese, si dhe sqarimin e metodave me eksperiencë (empirike) dhe teknike në shqyrtimin e dukurive komunikuese. Qëllimi është studentët të mund të sqarojnë dhe t'i dallojnë metodat kryesore cilësore dhe sasiore (mënyrat dhe procedurat) dhe teknikat kryesore (mjetet) në hulumtimet komunikuese, t'i identifikojnë dhe t'i aplikojnë fazat e veçanta në projektin komunikues dhe ta kuptojnë mënyrën e të shkruarit të raportit hulumtues. Studentët do t'i aplikojnë njohuritë dhe të kuptuarit në përpunimin e skicës ideore për hulumtim komunikues me të gjithë fazat e saj e cila do të gjejë zbatim në aplikime për projekte në fusha të rëndësishme të sektorëve politikë- shoqërorë, kulturorë, profesionalë, të komunikimit masiv dhe biznesit, posaçërisht tek organizatat e sektorit civil.

- **Diplomacia**

Lënda i njofton studentët në themelet e sqarimit teorik të themeleve të marrëdhënieve diplomatike, jep një pasqyrë të zhvillimit, të rolit dhe rëndësisë së diplomacisë në komunikimin ndërkombëtar dhe të aplikimit praktik të aftësive diplomatike në prezantimin e jashtëm të shteteve në planin politik, ekonomik dhe kulturor.

- **Komunikimi ndërkombëtar dhe identiteti kulturor**

Pas përfundimit të kursit komunikimi ndërkombëtar dhe identiteti kulturor studentët do të kenë mundësi të identifikojnë dhe të analizojnë aspektet themelore të identitetit të tyre kulturor, si dhe të jenë të vetëdijshëm për ekzistencën e identiteteve të tjera kulturore përveç të tyre. Përveç kësaj, studentët do të mund të aplikojnë teori të duhura për analizim të komunikimeve të ndryshme ndërkulturore. Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të komunikojnë në kontekste të ndryshme me vetëdije më të rritur për dallimin në mes njerëzve nga kultura të ndryshme.

- **Sistemet ndërkombëtare të komunikimit**

Njohje me sistemet tradicionale dhe ndërkombëtare të komunikimit. Fitimi i njohurive për sistemet e komunikimit të cilat kanë rëndësi për studimin bashkëkohor të proceseve komunikuese në shoqëri, prej tradicionaleve dhe deri te sistemet moderne të mediave në vende të ndryshme (në veçanti në hapësirën evropiane). Bëhet fjalë për sisteme të komunikimit dhe për modele të zhvilluara në korniza sociologjike, politike, psikologjike, dhe të teorive të tjera dhe shkolla vëmendja e të cilave është e përqendruar në proceset komunikuese në shoqërinë globale. Fokusi është në qasjen ndërdisiplinore në hulumtimin e proceseve të ndërlukuara të komunikimit dhe vënies së integritimit në disiplina të ndryshme shkencore.

- **Marrëdhënie me publikun: parimet dhe praktikat**

Njohje me parimet themelore, ligjet dhe zhvillimi i marrëdhënieve me publikun. Fitimi i njohurive për konceptin e marrëdhënieve me publikun, definicioni dhe zhvillimi historik, roli i ri i marrëdhënieve me publikun në pajtueshmëri me procesin e menaxhmentit dhe teoritë e reja për marrëdhënie me publikun.

- **Organizatave ndërkombëtare**

Kjo lëndë fokusohet në studimin e historisë, strukturave dhe funksioneve të organizatave ndërkombëtare dhe në sistemet e brendshme komunikuese në vetë organizatat. Duke shqyrtuar aktet e themelimit, parimet themelore të përgjegjësive ligjore dhe funksionimit të organizatave ndërkombëtare dhe vetë shteteve anëtare të atyre organizatave. Do të shqyrtohet mënyra dhe sistemi i komunikimit i Kombeve të Bashkuara, NATO-s, BE-së, OBSE, Këshillit të Evropës, etj.

- **Praktika profesionale**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë aftësi në fushën e punës praktike që t'i shtojnë mundësitë e tyre për punësim pas diplomimit. Studentët do të mundën më lehtë t'i identifikojnë mundësitë për zhvillimin e karrierës së tyre profesionale, si dhe njohuritë për strategjitë e teknikat për kërkime në tregun e punës në rajon dhe më gjerë.

- **Të shkruarit dhe raportimi medial**

Kjo lëndë ka për qëllim përparimin e aftësive praktike të studentëve për shkrim gazetaresk dhe raportim në mediat e shkruara dhe elektronike. Kjo lëndë do t'u japë studentëve udhëzime praktike për teknikat themelore të shkrimit medial. Studentët do të aftësohen të shkruajnë për gazetatat, radion dhe televizionin. Po ashtu, studentët do të fokusohen si t'i mbledhin, si t'i verifikojnë dhe t'i prezantojnë lajmet para opinionit të gjerë.

- **Komunikimi politik**

Nëpërmjet lëndës komunikimi politik sqarohet dhe analizohet komunikimi politik, i cili ka histori që prej kur ekziston

bashkësia politike, megjithatë nuk merret me anën historike, duke dashur të mbahet me kohërat moderne dhe në aktualitetin politik. Lënda po ashtu ka pikë të përbashkëta me problemet e të menduarit publik, por më së shumti merret me natyrën e marrëdhënies në mes politikanëve dhe mediave. Pas përfundimit të mësimit, studenti do të ketë mundësi të kuptojë dhe të zbatojë pikëpamjet në lidhje me krijimin politik dhe komunikimin dhe mënyrën e përvetësimit të ideve dhe qëndrimeve. Ata duhet ta kuptojnë rrezikun e psikologjisë së masave dhe etimologjinë e tyre me ndihmën e shembujve nga e kaluara e afërt dhe e largët.

- **Negociatat**

Lënda jep mundësi për të ofruar teknikat e negociimit, njohjen e taktikave të pandershme me qëllim të krijimit të situatave të ndërsjella të dobishme. Kursi fokusohet në teorinë e negociimit me zbatimin e saj praktik. Theksi është në gjuhën e trupit, llojet e personalitetit, dallimet rajonale dhe ndërkombëtare si dhe në kuptimin e fshehur të fjalëve.

- **Komunikimi dhe lidhshëria**

Kjo lëndë hulumton historinë e teorive të lidhshërisë me vëmendje primare të lidhshërisë të transformimit. Motivohet pjesëmarrja e bërjes së lidhshërisë me vëmendje të veçantë në mundësitë të komunikohet lidhshëria e transformimit.

- **Punim diplome**

Ky është një aktivitet lidhur me punimin e diplomës dhe projekt profesional. Nga studentët kërkohet ta shkruajnë një projekt që zakonisht lidhet me punën e diplomës, të punohet struktura e projektit, të bëhet një hulumtim dhe të shkruhet raporti.

- **Mediat ndërkombëtare**

Njoftim me parimet themelore, ligjet dhe zhvillimin e mediave ndërkombëtare. Fitimi i njohurive për konceptin dhe fuqinë e mediave ndërkombëtare, roli dhe rëndësia e tyre shoqërore, tendencat dhe sfidat gjatë zhvillimit të tyre, politika mediale, efektet e mediave, standardet ndërkombëtare.

- **Globalizimi**

Qëllimi kryesor i programit mësimor nga kursi i globalizimit dhe identitetit kulturor është që t'i referojë studentët në disa nga çështjet qendrore në lidhje me problematikën komplekse të globalizimit dhe identitetit kulturor. Studentët do të mund t'i sqarojnë aspektet ekonomike, politike dhe kulturore të globalizimit mbi civilizmin bashkëkohor dhe në mënyrë kritike të kontribuojnë në sqarimin e çështjeve të hapura si shkurtesa bashkëkohore- evropizimi, amerikanizimi, apo kosmpolitizmi i vlerave kulturore. Do të mund të shkruajnë, të krijojnë porosi komunikuese dhe të debatojnë për fenomenin shoqëria moderne dhe komunikimi modern me anë të rolit dhe ndikimit në standardizimin e vlerave evropiane dhe botërore dhe në nxitjen e zhvillimit të identiteteve të tyre kulturore.

- **Korrespondencë diplomatike**

Lënda ka për qëllim t'i aftësojë studentët në drejtim të të kuptuarit të rregullave ndërkombëtare të komunikimit në bashkësinë ndërkombëtare, sidomos në diplomaci. Fokusi do të përqendrohet tek rregullat dhe modalitetet për realizimin e komunikimit ndërkombëtar mes elitave politike dhe diplomatike. Rëndësi të veçantë kanë stilet e komunikimit brenda misioneve diplomatike (ambasadat dhe konsullatat). Целта на предметот е да се оспособат студентите во насока на разбирање на м

- **Politikat ndërkombëtare**

Lënda i shtjellon sistemet politike bashkëkohore, metodologjinë e hulumtimit të fenomeneve politike në planin ndërkombëtar, tipologjizimin dhe klasifikimet bashkëkohore të politikave ndërkombëtare përmes qasjes shkencore në analizën politike të strukturës, organizimit dhe funksionimit të sistemeve politike ndërkombëtare.

- **Rrjetat sociale**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri profesionale në lidhje me rrjetet sociale në internet, me mënyrën e operimit, përdorimit, abuzimit dhe mbrojtjen prej abuzimit. Lënda thekson se si rrjetet sociale shfrytëzohen si mjete për aktivitete të ndryshme, se si ato e ndryshojnë mënyrën në të cilën organizatat komunikojnë dhe bashkëveprojnë me audiencën e tyre, si rrjetet sociale duhet të koordinohen me objektivat e biznesit dhe të gjithë strategjinë e komunikimit dhe se si ato duhet të inkorporohen në funksione të ndryshme organizative.

- **Komunikimi ndërkombëtar dhe zgjidhja e konflikteve**

Komunikimi ndërkombëtar dhe zgjidhja e konflikteve është një fushë e studimit që zgjon interesim gjithnjë e më të madh si rezultat i proceseve bashkëkohore të globalizimit. Komunikimi global i mundësuar me ndihmën e

teknologjisë moderne krijon një platformë për një numër të stërmadh të komunikimeve të përditshme midis të kulturave të ndryshme. Në këtë kuptim, kjo lëndë synon të na i bëjë me dije problemet që mund ta vështirësojnë procesin e komunikimit midis kulturave të ndryshme. Tema që lidhen me problematikën e stereotipeve, me përgjithësimet, shkathhtësitë e komunikimit, orientimet dhe strategjitë komunikative janë pjesë e materialit thelbësor që do trajtohet në këtë lëndë. Pritjet janë që studentët të fitojnë: - Aftësi që t'i shpjegojnë dimensionet e llojllojshme të komunikimit ndërkulturor që mund të shkaktojnë një situatë konflikti; - Të jenë të aftë ta analizojnë në mënyrë kritike dinamikën e ndërveprimit ndërkulturor; - Të jenë të gatshëm për përgatitjen dhe planifikimin e strategjisë për ndërveprimin ndërkulturor; - Të përgatisin një studim për ndonjë rast të komunikimit ndërkulturor dhe të zgjidhjes së konflikteve.

Lëndë zgjedhore

• Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1, nga studentët pritet t'i zgjerojnë dhe t'i forcojnë aftësitë e tyre për shprehje më të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e mjediseve të ndryshme profesionale. Studentët pritet të jenë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë tekste të ndryshme profesionale në maqedonisht. Ata gjithashtu pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me terminologjinë e përgjithshme nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhës dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në korniza të profesioneve të tyre të ardhshme. Përveç përmblidhjes së këtyre qëllimeve profesionale, studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në një ambient shumëgjuhësor dhe shumëkulturor.

• Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2, nga studentët pritet t'i rikonfirmojnë dhe t'i zgjerojnë më tej aftësitë e tyre për shprehje të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e profesioneve të tyre të ardhshme. Ata do të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe të kuptojnë lloje të ndryshme të teksteve profesionale në maqedonisht, të analizojnë dhe t'i diskutojnë këto tekste, si dhe t'i krijojnë dokumentet e tyre, duke përfshirë biografi profesionale në maqedonisht (CV). Ata gjithashtu duhet t'i zgjerojnë njohuritë e terminologjisë specifike nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhëve dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në simulimin e situatave autentike nga mjediset profesionale në debate dhe në shkëmbim mendimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të këtyre profesioneve

• Gjuhë maqedonase për fillestarë 1

Programi për Gjuhën maqedonase për fillesatë përfshin: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Përmes ushtrimeve të vecanta dhe ligjëratave u mundësohet studentëve ta njohin komunikimin bazë në gjuhën maqedonase, d.m.th, të njoftuarit, përsëritjet, prezantimin si dhe pasurimin e fondit të fjalëve bashkë me të shkruarit dhe të kuptuarit të teksteve të vogla. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund edhe të zbatohen edhe mëtutje. Materiali përpunohet sipas parimit të ligjëratave dhe ushtrimeve të kombinuara si dhe detyrave të vazhdueshme përmes të cilave studentët përfshihen në mënyrë aktive gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje dhe propozime për mbarëvajtjen e orës.

• Gjuhë maqedonase për fillestarë 2

Programi për gjuhë maqedonase 2 për fillestarë përfshin: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Në suaza të kësaj lënde përfshihen gjerat në vijim: detyra të përditshme, plainifikimi I aktiviteteve për periudhën e ardhshme, përshkrimi I personave, vendeve dhe lëndëve. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje.

• Gjuhë shqipe për fillestarë 1

Lënda Gjuhë shqipe për fillestarë 1 është e përgatitur me qëllim që studentëve të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione) të thjeshta. Edhe pse bëhet fjalë për një kurs të shkallës së dytë për fillestarë, ky është menduar të jetë fleksibil dhe t'u përshtatet mundësive e interesave të studentëve.

• Gjuhë shqipe për fillestarë 2

Lënda Gjuhë shqipe për fillestarë 2 është e përgatitur me qëllim që studentëve të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të së njëjtës, të zgjerojnë dhe përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të zotërojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore, të cilat do ju mundësojnë biseda të thjeshta. Edhe pse bëhet fjalë për kurs të shkallës së dytë për fillestarë, ky është menduar të jetë fleksibil dhe t'u përshtatet mundësive dhe interesave të studentëve.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 1**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 2**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 3**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 4**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze 5**

Anglishtja akademike është lëndë një semestrale e cila ka për qëllim t'i mundësojë studentët me aftësitë të cilat do t'u lehtësojë të nxënit e gjuhës dhe progresin e të mësuarit të tyre në një mjedis akademik të të mësuarit dhe të nxënit. Numri i orëve është 30 (100 minuta, një herë në javë). Lënda duhet t'u mundësojë atyre t'i përdorin këto aftësi jo vetëm në gjuhën e huaj (në klasë të gjuhës amtare), por dhe në sferat e përmbajtjes. Lënda përfshin aftësitë gjuhësore, aftësitë studimore dhe në përgjithësi aftësitë e zbatueshme (dëgjim, bërje të prezantimeve gojore, ndërtim argumentesh) në detyra të veçanta. Prandaj, pas përfundimit të lëndës studentët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë në mënyrë të suksesshme prezantime me gojë, të marrin pjesë në një debat/ diskutim online duke deklaruar mendimet dhe argumentet e tyre dhe t'i japin arsyetimet e tyre në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje ta dëgjojnë dhe ta lexojnë thelbin dhe detajin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke deklaruar mendimin e tyre. Ata duhet të shkruajnë paragraf dhe ese për zgjidhje të problemit. Duhet t'i njohin shkurtesat dhe simbolet në fjalor si dhe ta praktikojnë përdorimin e fjalorit njëgjuhësor. Ata duhet të jenë në gjendje

ta prezantojnë informatën vizuale në formën e prezantimeve afishe. Studentët duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë idetë kryesore dhe të dhënat mbështetëse në një tekst, dhe t'i analizojnë dhe t'i identifikojnë fjalitë e temës në një paragraf. Ata duhet të jenë në gjendje ta identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe t'i zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

- **Gjuhë angleze 6**

Anglishtja akademike është lëndë një semestrale e cila ka për qëllim t'i mundësojë studentët me aftësitë të cilat do t'u lehtësojë të nxënit e gjuhës dhe progresin e të mësuarit të tyre në një mjedis akademik të të mësuarit dhe të nxënit. Numri i orëve është 30 (100 minuta, një herë në javë). Lënda duhet t'u mundësojë atyre t'i përdorin këto aftësi jo vetëm në gjuhën e huaj (në klasë të gjuhës amtare), por dhe në sferat e përmbajtjes. Lënda përfshin aftësitë gjuhësore, aftësitë studimore dhe në përgjithësi aftësitë e zbatueshme (dëgjim, bërje të prezantimeve gojore, ndërtim argumentesh) në detyra të veçanta. Prandaj, pas përfundimit të lëndës studentët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë në mënyrë të suksesshme prezantime me gojë, të marrin pjesë në një debat/ diskutim online duke deklaruar mendimet dhe argumentet e tyre dhe t'i japin arsyetimet e tyre në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje ta dëgjojnë dhe ta lexojnë thelbin dhe detajin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke deklaruar mendimin e tyre. Ata duhet të shkruajnë paragraf dhe ese për zgjidhje të problemit. Duhet t'i njohin shkurtesat dhe simbolet në fjalor si dhe ta praktikojnë përdorimin e fjalorit njëgjuhësor. Ata duhet të jenë në gjendje ta prezantojnë informatën vizuale në formën e prezantimeve afishe. Studentët duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë idetë kryesore dhe të dhënat mbështetëse në një tekst, dhe t'i analizojnë dhe t'i identifikojnë fjalitë e temës në një paragraf. Ata duhet të jenë në gjendje ta identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe t'i zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

- **Të folurit publik**

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të fitojnë njohuri në lidhje me procesin e komunikimit, përgjegjësitë etike të të folurit publik dhe llojet e ndryshme të fjalimeve informative dhe bindëse. Përveç kësaj, studentët do të fitojnë njohuri të nevojshme për përgatitjen dhe dhënien e llojeve të ndryshme të fjalimeve, aftësi për ta analizuar publikun, të gjurmojnë tema për fjalime, të përgatisin fjalime, e të tjera. Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike duke qenë vetëkritikë konstruktivë dhe gjithashtu kritikë ndaj fjalime të kolegëve.

- **Debat dhe shkathtësi prezantimi**

Nga kjo lëndë studentët: do të përfitojnë shkathtësi për diskutim dhe argumentim efektiv si dhe do të zhvillojnë vetëbesim për të folur para publikut; do të përpilojnë, do të zhvillojnë dhe do të ushtrojnë prezantimin e argumenteve në mënyra të ndryshme përfshirë punën individuale, në çifte dhe prezantime në grupe; do të mësojnë të përdorin retorikë bindëse, me qëllim të gjetjes së argumenteve që mbështesin një pozitë të caktuar lidhur me temat aktuale; ndjekja e kësaj lënde do t'u mundësojë të njihen në mënyrë më të hollësishme me proceset e debatit formal, gjegjësisht me stilin parlamentar britanik për debate;

- **Studime ndërkulturore**

Pasi ta kenë përfunduar lëndën, studentët do të mund t'i identifikojnë çështjet globale dhe problemet nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të kulturave tjera. Aq më shumë, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipat që shoqëria i ka për kulturat e ndryshme dhe, si pasojë, më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët do të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike mbi tema rreth etnisë së tyre, identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare, moshën si dhe karakteristika të tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të kursit Studime ndërkulturore studentët do të fitojnë aftësi të të komunikuarit të nevojshme për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë aftësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

- **Aftësitë e komunikimit**

Lënda është dizajnuar t'u mundësojë studentëve që praktikisht ta zbatojnë komunikimin ndërpersonal. Studentët do të mësojnë aftësi ndërpersonale siç janë: perceptimi, të dëgjuarit, komunikimi verbal dhe ai jo verbal; do ta ushtrojnë të folurit publik, si për shembull: organizimin, prezantimin dhe bazat e të shkuarit fjalime publike. Studentët do të kenë mundësinë të praktikojnë komunikimin në grupe të vogla, duke filluar nga: lidhësi, vetëbesimi dhe të dëgjuarit. Kursi po ashtu ofron njohuri themelore të nevojshme për ta kuptuar procesin e kërkimit të një vendi pune nëpërmjet komunikimit me shkrim dhe me gojë, duke shkruar rezyme, letër motivimi dhe duke simuluar intervista.

- **Excel i avancuar**

Qëllimi i lëndës është që t'i informojë studentët me aplikacionin Microsoft Excel dhe duke shfrytëzuar mundësitë që

ofron ky aplikacion të jenë në gjendje të kryejnë detyra të avancuara të cilat janë ngushtë të lidhura me programin fakultativ të tyre.

- **Aftësitë të avancuara të TI-së**

Qëllimet e lëndës janë: T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri themelore dhe aftësi në fushën e shkencave informative dhe t'i njoftojë studentët me mundësitë që ato i ofrojnë; T'i pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike rreth aplikacioneve të Microsoft Office (Windows, Word, PowerPoint, Excel, Access) dhe t'ju mundësojë që këto aplikacione edhe t'i aplikojnë në jetën e përditshme; T'u mundësojë studentëve të punojnë projekte praktike individuale ose në grupe.

- **Word i avancuar**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i pajisë studentët me aftësi të avancuara rreth përdorimit të Word-it dhe PowerPoint-it. Ky kurs gjithashtu u mundëson studentëve që në mënyrë të pavarur të zbatojnë projekte të ndryshme si dhe detyra të veçanta komplekse të cilët janë të lidhura me programin e studimeve të tyre.

- **Google Apps**

Qëllimet e lëndës janë: T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri dhe aftësi të avancuara në fushën e shërbimeve elektronike (cloud applications); T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri teorike dhe praktike rreth Google Docs (G-mail, dokumente, spreadsheets, prezantime, vizatime dhe formulare) dhe t'i aplikojnë ato në jetën e tyre; T'u mundësojë studentëve të punojnë individualisht ose në grupe në projekte të ndryshme drejtpërdrejt nga web browser-i.

- **Access-i i avancuar**

Bazat e të dhënave (databases) janë mjete ideale për ndjekjen e vëllimeve të mëdha. Microsoft Access-i është një mjet mjaft i fuqishëm dhe i popullarizuar i cili përdoret për hartimin dhe zhvillimin e Windows-based databases. Ky kurs është i dizajnuar për përdorues të rinj të Access-it ku janë të përpunuara funksionet e nevojshme për të punuar me bazat e të dhënave.

- **Desktop publikimi**

Qëllimi i kësaj lënde është hartimi dhe përpunimi i grafikave raster dhe vektor përmes programeve kryesore të Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe hartimi dhe botimi i materialeve komerciale për shtyp duke përdorur Adobe InDesign.

- **Publikimi ueb**

Zhvillimi i një ueb faqeje qoftë edhe e thjeshtë në përputhje me standardet aktuale kërkon njohuri të gjuhës së Hypertext Markup (XHTML) dhe Cascading Style Sheets (CSS). Shumë faqe ueb përdorin imazhe qoftë në formë të banerëve, sustave, logove, fotografive apo skenimeve. Adobe Fireworks është ndërtuar si një mjet për të krijuar dhe manipuluar imazhet e destinuar për ueb dhe për t'iu mundësuar krijuesve që t'i përdorin këto imazhe për të zvogëluar madhësinë e fajllit. Fireworks gjithashtu ofron një integrim të shkëlqyer me Dreamweaver. Kjo seri ofron një hyrje të plotë në XHTML, CSS dhe krijimin e grafikës për ueb.

- **Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi**

Lënda Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi është një sintezë e rregullave dhe udhëzimeve të cilat janë të parapara për t'i përmirësuar shkathtësitë e të shprehurit me shkrim dhe me gojë në gjuhën shqipe. Përmirësimi i këtyre shkathtësive, para së gjithash, parashihet që të realizohet përmes familjarizimit me rregullat drejtshkrimore dhe disa norma morfologjike e sintaksore të gjuhës shqipe që shihen si të nevojshme që të arrihet përdorimi i drejtë i gjuhës. Më pas, theks i veçantë i kushtohet motivimit të studentëve për ligjërim të rrjedhshëm, rritjes së vetëdijes për përdorimin e gjuhës së pastër dhe standarde shqipe. Gjithashtu, hapësirë të veçantë zë edhe nxitja e vullnetit për përmirësim të procesit të shkruarit, duke i vetëdijësuar studentët për dallimet e llojeve të teksteve të shkruara, por edhe për vetëdijen për integritet akademik në punimet serioze kërkimore (plagjiaturën), duke mos lënë pas as përfshirjen e terminologjisë specifike të fushave të ndryshme në të cilat janë të orientuara studentët. Të gjitha këto tema janë paraparë që studentëve t'u ofrohen si njësi mësimore të kombinuara, gjegjësisht si rregulla, udhëzime e ushtrime që plotësohen mes veti.

- **Gjuha shqipe për qëllime specifike**

Lënda ka për qëllim përmirësimin dhe përsosjen e të shprehurit në gjuhën shqipe, qoftë me gojë ose me shkrim. Në mënyrë të veçantë lënda ka për qëllim të njoftojë studentët me terminologjinë specifike, mundësitë e përdorimit të saj, me gabimet më të shpeshta në të folurit e përditshëm, por edhe për komunikim në rrethana specifike. Studentët do të njoftohen me kushtet në të cilat ata rregulla hyn në përdorim, në mënyrë që mund ti përdorin jo vetëm për detyrat në lidhje me këtë temë, por edhe në karrierën e tyre të ardhshme profesionale.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën angleze**

Në këtë lëndë do të zhvillohen shkathtësitë akademike të të shkruarit të studentëve në mënyra të ndryshme. Studentët do të aftësohen t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe efektive që të prodhojnë një pjesë të shkruar. Gjithashtu, studentët do të njoftohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do të vetëdijësohen se çka është plagjiatura. Informata kthyesë e një pjesë të shkruar do të përfshijë vetëkorrigjimin, korrigjimin e njëri-tjetrit dhe korrigjimin nga ana e mësimitdhënësit të përmbajtjes, organizimit dhe gabimeve gjuhësore gjatë procesit të të shkruarit.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën maqedonase**

Pas mbarimit të kësaj lënde, nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të përshtatshme dhe komunikim të avancuar në gjuhën maqedonase me theks të veçantë në aftësitë e të shkruarit. Pos kësaj, pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm. Për më tepër, studentët do të jenë në gjendje t'i përmirësojnë aftësitë e tyre të të shkruarit në më shumë nivele dhe në këtë mënyrë do të bëhen më të sigurt dhe më kompetentë gjatë të shkruarit në gjuhën maqedonase. Studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin konkludime. Studentët, gjithashtu, do të zhvillojnë aftësi për shkrim dhe komunikim të shkëlqyer në gjuhën maqedonase.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën shqipe**

Në fund të çdo niveli studentët do të jenë në gjendje të shkruajnë ese dhe punime kërkimore bazuar në rregullat e mësuar gjatë ligjëratave. Më konkretisht, nga studentët pritet që t'i mësojnë funksionin, strukturën dhe llojet e ndryshme të paragrafëve, mënyrat se si të zgjedhin tema për punime kërkimore, si të grumbullojnë materiale, rregullat se si t'i dokumentojnë referencat e të arrijnë deri tek modeli përfundimtar.

- **Gjuha gjermane (niveli 1-4)**

Pas përfundimit të çdo niveli nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën Evropiane të Gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimit të gjuhës. Deri në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin përfundime. Studentët gjithashtu do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojarisht në gjuhën gjermane."

- **Mbrojta e ambientit**

Qëllimet e lëndës janë: T'i njoftojë studentët me problemet kryesore të mjedisit; T'i njoftojë studentët me rolin e njeriut si faktor kyç në procesin e ndotjes dhe mbrojtjes së ambientit; T'i njoftojë studentët me ndikimin e ndotësve të ndryshëm të ambientit në shëndetin e njeriut, veprimtarinë profesionale dhe aftësitë organizuese të faktorit njerëzor; Krijimi i shprehive pozitive ndaj ambientit dhe ngritja e vetëdijes për një mjedis më të shëndetshëm dhe më të pastër; Legjislatiioni ndërkombëtar dhe kombëtar dhe konventat ndërkombëtare mbi mjedisin; Hyrje në politikat globale kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjedisit; Mjedi si një kusht për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; Roli i shoqërisë në mbrojtjen e mjedisit; Njoftimi me rreziqet kryesore për një mjedis të shëndetshëm; Njoftimi me Strategjinë kombëtare të mjedisit në Republikën e Maqedonisë.

- **Zhvillimi profesional i karrierës**

Kjo lëndë ofron mësim praktik të orientuar drejt rezultateve për kërkim. Po ashtu lënda i aftëson di ta fitojnë dhe si ta mbajnë vendin e punës. Ka për qëllim që studentëve t'u sigurojë aftësi të përshtatshme për vende pune moderne. Detyrë kryesore do të jetë përpilimi i CV, shkrimi i letrës së interesit/kërkesës, aftësitë për të intervistuar, komunikimi zyrtar në zyrë (memorandume, e-maile oficiale për mbikëqyrësit, konsumatorët, raporte e të tjerë). Elemente shtesë që do t'i përfshijë kjo lëndë janë: si të bëhet vetëvlerësimi, si të menaxhohet konflikti midis dy zyrave dhe si të kërkohet në mënyrë aktive promovimi. Aftësitë e fituara në këtë lëndë do të jene të zbatueshme edhe në procesin e kërkimit të punës në përgjithësi.

- **Liritë dhe të drejtat e njeriut**

Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet historike për t'i identifikuar ato. Me kalimin e kohës, korpusi i të drejtave dhe lirive të njeriut që mbrohen me ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare është zgjeruar, por kjo nuk do të thotë se ato respektohen në praktikë. Në fillim, të drejtat e njeriut konsideroheshin si çështje të mbrendshme të shteteve (sipas parimit të sovranitetit absolut të shtetit) dhe vetëm në kohërat më të reja ato fituan statusin e normave kogente. Kjo lëndë e studion zhvillimin e doktrinës për të drejtat e njeriut, llojet dhe kategoritë e të drejtave të njeriut dhe dokumentet kryesore që i rregullojnë dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Kjo lëndë ka për qëllim: t'i njoftojë studentët me konceptin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, me zbatimin e tyre dhe me ndikimin që ato kanë në formulimin e politikave kombëtare. Kjo do t'i inkurajojë studentët të reflektojnë në mënyrë kritike mbi raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe të asaj kombëtare, do t'i vetëdijësojë ata për ndryshimet ndërkombëtare në këtë drejtim dhe për mënyrën si këto të drejta ndikojnë në jetën e njerëzve në botë. Dhe do t'i nxisë që të kontribuojnë në

përparimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

- **Gjuhë angleze për administratë publike, shkenca politike dhe komunikim 1**

Anglishtja për administratë publike dhe shkenca politike 1 dhe 2 është lëndë semestrale dhe u dedikohet studentëve nga këto programe studimore. Njëkohësisht, studentët që studiojnë komunikim ndërkombëtar mund ta ndjekin atë. Programi bazohet në përmirësimin dhe përvetësimin e gjuhës angleze në tërësi, përvetësim të një terminologjie të posacme nga lëndët profesionale të këtyre fushave, zhvillim dhe përmirësim të shtathtësive akademike të të shkruarit dhe të të lexuarit, si dhe diskutim tekstesh dhe përshkrime nga fusha e administratës publike, shkencave politike si dhe komunikimit dhe raporteve ndërkombëtare. Materialet që përdoren rrjedhin nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe tekste nga botues të mëdhenj, si dhe tekste dhe materiale autentike. Theks i veçantë në lëndën në fjalë i kushtohet terminologjisë profesionale për qëllime komunikimi e cila do të jetë e zbatueshme gjatë ndërtimit të karrierës së studentëve.

- **Komunikimi ndërkombëtar në Evropë**

Studentët do të jenë në gjendje të definojnë komunikimin ndërkombëtar në Evropë, t'i identifikojnë dhe t'i sqarojnë hapësirën mediale evropiane dhe kulturën mediale evropiane, ndërsa njohurinë do t'i aplikojnë në përpunimin e politikave dhe rregulloreve kombëtare dhe evropiane audiovizuale me aftësi për të vlerësuar situata komunikimesh specifike në bazë të standardeve të aplikuara evropiane dhe të kriterëve në përmbajtjet komunikuese dhe të menduar kritik në strukturën e sistemeve të komunikimit evropian si mjete për shprehje të tyre.

- **Komunikimi ndërpersonal**

Qëllimi i programit të lëndës është që studentët të fitojnë njohuri nga teoria dhe praktika e komunikimit ndërpersonal. Studentët do të hulumtojnë procesin komunikues, do të vlerësojnë të kuptuarit e komunikimeve ndërpersonale dhe marrëdhënieve, do ta vlerësojnë rolin e komunikimit në krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve efektive ndërnjerëzore dhe do ta vlerësojnë rolin e komunikimit si qytetarë në shoqëri.

- **Studime kulturore**

Prej studentëve pritet të arrijnë njohuri hyrëse teorike për fenomenet dhe konceptet kulturore. Do të mundën ta përcaktojnë ndikimin dhe ndryshimet e kulturës në shoqëri. Pas përfundimit të kursit do të mendojnë në mënyrë kritike për socializimin dhe kulturën nëpërmjet përcaktimit dhe zgjidhjes së dallimeve dhe ngjashmërive kulturore, si dhe të debatojnë për ndryshimet në kulturë siç janë akulturimi, nënkultura dhe kundërkultura, për etnocentrizmin, kulturat nacionale dhe kosmopolitizmin.

- **Të bindurit**

Qëllimet e programit të lëndës: - Studentët të njihen me lëndën e bindjes; - Studentët të njihen me metodat dhe teknikat e bindjes; - Studentët t'i përdorin metodat dhe teknikat e testimit të teorive, parimeve dhe strategjive të ndikimit social në kontekste të ndryshme të komunikimit; - Studentët t'i përdorin metodat dhe teknikat e komunikimit kryesisht për marrjen e pëlqimit, metodat e bindjes dhe etikën e ndikimit social në kontekste ndërpersonale dhe profesionale; - Studentët të aplikojnë bindje brenda konteksteve të ndryshme, duke përfshirë edhe marrëdhëniet, organizatat, fushatat ligjore dhe kulturën masive; Цели на предметната програма:

- **Gjuhë angleze për administratë publike, shkenca politike dhe komunikim 2**

Anglishtja për administratë publike dhe shkenca politike 1 dhe 2 është lëndë semestrale dhe u dedikohet studentëve nga këto programe studimore. Njëkohësisht, studentët që studiojnë komunikim ndërkombëtar mund ta ndjekin atë. Programi bazohet në përmirësimin dhe përvetësimin e gjuhës angleze në tërësi, përvetësim të një terminologjie të posacme nga lëndët profesionale të këtyre fushave, zhvillim dhe përmirësim të shtathtësive akademike të të shkruarit dhe të të lexuarit, si dhe diskutim tekstesh dhe përshkrime nga fusha e administratës publike, shkencave politike si dhe komunikimit dhe raporteve ndërkombëtare. Materialet që përdoren rrjedhin nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe tekste nga botues të mëdhenj, si dhe tekste dhe materiale autentike. Theks i veçantë në lëndën në fjalë i kushtohet terminologjisë profesionale për qëllime komunikimi e cila do të jetë e zbatueshme gjatë ndërtimit të karrierës së studentëve.

- **Menaxhment ndërkombëtar**

Kjo lëndë do t'i shqyrtojë çështjet ndërkulturore dhe ndërkombëtare të menaxhimit dhe do t'i analizojë problemet e menaxhimit në tregun ndërkombëtar. Lënda do të fokusohet në llojlojshmërinë kulturore dhe rajonale, ndikimet politike dhe ekonomike, tregun global si dhe detyrimet e tjera me të cilat zakonisht ndeshen menaxherët e

ndërmarrjeve multinacionale. Lënda mbulon një gamë të praktikave të menaxhimit - prej burimeve njerëzore deri në motivimin e fuqisë punëtore multikulturore për kompani të mëdha dhe të vogla ndërkombëtare. Aktivitete në klasë, ushtrime për vetëvlerësim dhe analizë të rasteve të veçanta do të përdoren për hulumtim të dimensioneve ndërkombëtare të sjelljes organizative, si për shembull, udhëheqje, vendimmarrje, zgjidhje e problemeve dhe zgjidhje e konflikteve.

- **Komunikimi ndërkulturor: përmbajtjet dhe strategjitë kulturologjike**

Pas përfundimit të lëndës komunikimi ndërkulturor: përmbajtje dhe strategji kulturologjike studentët do të kuptojnë mënyrën se si dallohen proceset komunikuese mes kulturave. Ata po ashtu do të mund të identifikojnë sfidat të cilat dalin nga këto dallime në interaksionet ndërkulturore dhe të jenë të vetëdijshëm për mënyrat me anë të të cilave në mënyrë kreative mund të adresojnë këto dallime. Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime të cilat do t'ua zmadhojnë kompetencën ndërkulturore.

- **Etika e komunikimit**

Lënda është e dizajnuar në atë mënyrë që studentëve do t'u sigurojë njohuri themelore dhe aftësi për etikën bashkëkohore të komunikimit. Morali bashkëkohor është në krizë. Atë e thotë edhe Sigmund Freud në librin e tij etika postmoderne. Etika bashkëkohore e komunikimit në kohën kur ajo është e hapur edhe Al Qaeda paraqet një sfidë të madhe për kufijtë moralë të shoqërisë bashkëkohore. Çështja e moralit, shundi, plehërat, plagjiatura, privatësia e individit janë çështje për të cilat studentët nëpërmjet veprave të Kant-it, Noam Chomsky-t, Manuel Castells-it, dhe të tjerëve do të fitojnë njohuri dhe aftësi se njeriu bashkëkohor, në veçanti gazetarët, duhet t'i njohin anët e mira dhe anët e këqija të profesionit dhe të artizanatit gazetaresk.

- **Parimet dhe praktikat e intervistimit**

Studentët përfitojnë njohuri teorike dhe praktike nga e drejta kushtetuese si degë themelore e së drejtës, Kushtetuta si akti më i lartë juridik dhe politik i shtetit si dhe nga kushtetushmëria dhe ligjshmëria si parime bazë të shtetit juridik. Kjo lëndë i shtyn studentët në parimet themelore dhe praktikat e intervistimit si një zhanër i veçantë dhe i rëndësishëm i gazetarisë. Studentët do të njoftohen me parimet themelore të kryerjes së një interviste në mediat e shkruara dhe elektronike, dhe do të krahasohen përparësitë e intervistave si praktikë dhe si veprimtaritë konkrete në gazetari e posaçërisht shumë e njohur dhe e aplikuar në sferën e politikës dhe diplomacisë. Do të analizohen dhe praktikisht do të realizohen intervista informative dhe analitike, si dhe intervista të kombinuara (intervistë- portret dhe intervistë reportazh).

- **Aplikimi kompjuterik në komunikim**

Lënda është një hyrje në konceptet dhe parimet e aplikacioneve kompjuterike të cilat e mbështesin komunikimin. Shqyrtohen tema të ndryshme nga fusha e aplikacioneve kompjuterike në komunikim. Qëllimi i kësaj lënde është që studenti të pajiset me një të kuptuar gjithëpërfshirës të mjeteve dhe metodologjive për zgjidhje të problemeve që lidhen me krijimin e një faqeje efektive World Wide Web. Edhe pse do të shqyrtohen mjete konkrete, siç janë XHTML, fokusi ynë primar do të jetë për zgjidhjen e problemeve dhe teknikave për mbledhje të informatave të cilat e mbijetojnë çdo gjuhë të veçantë. Në ligjërata do të shqyrtohen konceptet e përgjithshme dhe sintaksa, derisa ushtrimet laboratorike do të fokusohen në implementim dhe praktikë.

- **Studime amerikane**

Pas përfundimit të lëndës studime amerikane studentët do të njoftohen me historinë amerikane, kulturën e tyre dhe mënyrën e jetesës. Studentët po ashtu do të përfitojnë aftësi komunikuese të shkruara dhe gojore si dhe aftësi për të menduarit kritik dhe për analizë.

- **Komunikimi i biznesit dhe profesional**

Studentët do të fitojnë aftësi themelore për komunikim profesional dhe të biznesit. Studentët do të përgatiten dhe do të bëjnë prezantim informativ të biznesit. Studentët do të përgatisin dhe bëjnë prezantim për shitje dhe marketing. Studentët do të dinë të përdorin format themelore të biznes korrespondencës. Studentët do të jenë të përgatitur të marrin pjesë në procese të vendimmarrjes në situata të ndryshme të komunikimit dhe në ambiente të ndryshme profesionale dhe të biznesit.

- **Media dhe shoqëria**

Mediat dhe shoqëria paraqet hyrje të studentëve në një disiplinë e cila i studion marrëdhëniet komplekse mes mediave dhe shoqërisë, rolin e mas mediave si teknologji ndërmjetësuese gjatë komunikimit masiv dhe global. Qëllimi i veçantë i lëndës janë implikimet politike, sociale dhe kulturore të mediave mbi shoqërinë.

- **Argumentim dhe debat**

Qëllimi i programit të lëndës është që studentët të përfitojnë njohuri nga teoria dhe praktika e argumentimit dhe debatit. Studentët do të mësojnë si t'i njohin argumentet, si t'i gjejnë ato gjatë bisedave, në shtypin ditor, po ashtu t'i zbulojnë edhe kundërthëniet. Studentët do të mësojnë si t'i vlerësojnë llojet e ndryshme të argumenteve, po ashtu do t'i mësojnë standardet të cilat duhet të jenë përfshirë në qëndrime.

- **Planifikimi i komunikimeve**

Njohje me taktikat e komunikimit, teknika dhe aftësi në marrëdhëniet me publikun dhe fusha të tjera. Përfitim njohurish për zhvillim të strategjisë së komunikimit përmes zhvillimit të planit të komunikimit, me zbatim të taktikave të komunikimit në komunikimin e biznesit dhe komunikimin masiv. Theksi është në proceset e planifikimit të cilat përfshijnë vizionin dhe strategjinë, planin dhe llogaritjen dhe realizimin e planifikimit si dhe instrumentet për komunikim.

- **Studime evropiane**

Lënda ka për qëllim t'i njoftojë studentët me institucionet evropiane, politikat dhe rregulloret, kushtet, proceset dhe perspektivat e proceseve integruese evropiane. Studentët do të fitojnë njohuri dhe aftësi për integrimin evropian nga aspekti i komunikimit ndërkombëtar dhe do ta zbatojnë në përgatitjen e projekteve evropiane nga aspekti komunikativ.

- **Të shkruarit e lajmit**

Qëllimi i kësaj lënde është të zhvillojë aftësitë e studentëve për shkruarje të një artikulli themelor të medias - lajmit. Përmes kësaj lënde studentët do të kenë mundësi që në mënyrë praktike të aplikojnë njohuritë teorike nga të shkruarit mediatik. Sa i përket asaj se si strukturohet lajmi, si raportohet nga vendi i ngjarjes etj.

- **Të shkruarit për marrëdhënie me publikun**

Të shkruarit për marrëdhënie me publikun paraqet një qasje më të plotë dhe më aktuale të të shkruarit të një teksti për publikun. Nga studentët pritet të fitojnë shumë teknika të domosdoshme që të arrihet komunikim i ndryshëm me publikun në kohën e sotme digjitale. Kjo u mundëson studentëve të njihen me llojet e materialit të shkruar për marrëdhënie me publikun, me mjetet themelore të marrëdhënieve me publikun dhe me format themelore gazetareske. Shkrimi është një nga format më të shpeshta dhe më me ndikim të komunikimit, kurse stili i të shkruarit është një nga shkathtësitë e njëmendëta, e cila në epokën e teknologjive të reja kërkon shpejtësi dhe shkathtësi për përvetësimin e gjuhës. Lënda i kushtohet zotërimit të artit të të shkruarit me njohjen e teknikave tradicionale, të formave, modeleve dhe praktikave që mundësojnë të shkruarit për të arritur një komunikim të mirë, të suksesshëm dhe efektiv në botën e medias. Njëherësh studentët do të njihen me konceptet e shkrim-leximit të medias, kredibilitetin e përmbytjes së mediave dhe me standardet profesionale të raportimit. Puna praktike do t'u mundësojë studentëve të krijojnë një materiale të ndryshme që përdoren në marrëdhëniet me publikun. Do të sigurohet zbatimi i mjeteve për marrëdhënie me publikun dhe standardet profesionale në dizajnimin e materialeve për marrëdhënie me publikun dhe materiale të tjera për mediat.

- **Zhvillimi i karrierës profesionale**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë aftësitë për shkrim të përmbledhjes (CV), letrës së interesit, përgatitje për intervista për punësim, me qëllim që të rrisin mundësitë e tyre për punësim pas mbarimit të studimeve. Studentët do të mund t'i identifikojnë më lehtë opsionet për zhvillim të karrierës së tyre profesionale, si dhe të fitojnë njohuri për strategji dhe teknika për hulumtim të tregut të punës në rajon dhe më gjërë.